

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 18.11.2018]

Për: Operatorin Ekonomik “Hastoci” shpk, me adrese: rruga Pjeter Bogdani, pallati nr 17, apartamenti 5/3, perballe kopshtit nr 31, me NIPT J62028009B.

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Projekti zhvillimor i Bllokut nr. 2, Roskovec”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Projekti zhvillimor i Bllokut nr. 2, Roskovec”.**

Numri i referencës së procedurës: **REF-86287-09-18-2018.**

Kohëzgjatja: brënda 18 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 246.876.559 (dyqind e dyzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 49.375.312 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 29.10.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"SHKELQIMI 07" SHPK	K68121808W	152,000,000
2	"B 93" SHPK (50%)	J62903508R	154,228,372
	"BOSH NJAKU B" SHPK (50%)	K72627402H	
3	"HASTOCI" SHPK	J62028009B	193,736,484
4	"STERKAJ" SHPK (88%)	J68310708M	194,133,398
	NDREGJONI SHPK (12%)	K31329048I	

5	"ALBA KONSTRUKSION" SHPK	J61812013R	198,515,216
6	"MELA" SHPK (33%)	K62320011G	200,000,000
	"ALBSHPRESA" SHPK (76%)	J72110003F	
7	"ED KONSTRUKSION" SHPK (87.1%)	K61625001I	215,331,408
	SPEKTRI SHPK (12.9%)	J62903555F	
8	"BE IS" SHPK	K71412003A	217,726,686
9	"LALA" SHPK (53.27%)	J76418903B	222,835,474
	"BIBA X" SHPK (46.73%)	K32618815N	
10	"FUSHA" SHPK	J61922018S	239,468,735

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Shkelqimi 07” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi gjate vitit 2017, referuar puneve te ngjashme te deklaruar ne tender, ka ushtruar aktivitet ne bashkine Lushnje (rruga Hysgjokaj Kurtine, rruga Kodra e Hilajve etj), Durres (rruga ne fshatin Gjericaj), Vlore (rruga Risili), Divjake (shkolla Cerme) dhe nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e taksave dhe tarifave vendore.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi referuar kerkeses per kualifikim duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 123.438.279 leke pa tvsh ose disa pune te ngjashme me vlere jo me pak se 493.753.118 leke pa tvsh. Kjo shoqeri nuk ploteson asnje prej dy kushteve.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin minimal te punonjesve, pasi kjo shoqeri ne periudhen e kerkuar mars – gusht 2018 ka patur te angazhuar maksimumi 126 persona, nga te cilet 91 persona jane te angazhuar ne objektin “Rikonstruksioni i Rruges Ramize Gjebrea, Faza 2 (Lidhja e rruges se Pyllit te Sodes me rrugen Transballkanike dhe Autostraden)” sipas kontrates se lidhur me FSHZH. Numri i punonjesve te pa angazhuar eshte 35, i pamjaftueshem per te permbushur kushtin per kualifikim ku kerkohen 80 punonjes te pa angazhuar.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 dhe 2.3.5 per kualifikim lidhur me disponimin e inxhinierëve, pasi inxhinieret e paraqitur jane te deklaruar dhe te angazhuar ne proceduren “Rikonstruksioni i rruges Ramize Gjebrea, faza 2 (lidhja e rruges se pyllit te sodes me rrugen transballkanike dhe autostraden)”, ne te cilen kjo shoqeri eshte shpallur fituese ne daten 05.10.2018. Kontrata perkatese eshte lidhur ne daten 09.10.2018, perpara dates se hapjes se ofertave.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi mjetet e paraqitur ne kete procedure jane te deklaruar dhe te angazhuar ne proceduren “Rikonstruksioni i rruges Ramize Gjebrea, faza 2 (lidhja e rruges se pyllit te sodes me rrugen transballkanike dhe autostraden)”, ne te cilen kjo shoqeri eshte shpallur fituese ne daten 05.10.2018. Kontrata perkatese eshte lidhur ne daten 09.10.2018, perpara dates se hapjes se ofertave.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “B 93” shpk (50%) dhe “Boshnjaku B” shpk (50%) pasi:

Nga kontrolli i veprimeve aritmetike rezulton se vlere e ofertes pa tvsh eshte 165.544.444 leke dhe jo 154.228.372 leke (sa c'eshte shenuar ne formularin e ofertes dhe preventivin e dorezuar ne tender). Komisioni llogariti se gabimi aritmetik eshte ne vleren 11.316.072 leke ose mbi 7%. Per rrjedhoje, bazuar ne piken 4 te nenit 66 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” oferta refuzohet.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me shqyrtimin e dokumentacionit per kualifikim te paraqitur nga ky bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Sterkaj” shpk (88%) dhe “Ndregjoni” shpk (12%) pasi:

Shoqeria “Sterkaj” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi nuk ka paraqitur asnje objekt ku te kete kryer punime ndertim godinash nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime te tilla.

Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi gjate vitit 2017, referuar puneve te ngjashme te deklaruar ne tender, ka ushtruar aktivitet ne bashkine Elbasan (sistemim asfaltim rruga Belul Berisha) dhe Kamez (Ndertim rruga Migjeni & Mesonjetorja & Dardania) dhe nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e taksave dhe tarifave vendore.

Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 dhe 2.3.5 per kualifikim lidhur me disponimin e inxhinierëve, pasi ka marre persiper punime elektrike dhe nuk ka ing elektrik. ka marre persiper punime kondicionimi dhe nuk ka ing mekanik.

4. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Alba Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur pune te ngjashme vetem per punime rrugore, por nuk ka paraqitur asnje pune te ngjashme per punime ndertimore per godina.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve pasi:

- Mjeti autobitumatrice LU3021C, marre me qira nga “ISPP” shpk ne daten 20.02.2017, ne daten 5 qershor 2014 i eshte dhene me qera shoqerise “Bajrami N” shpk me afat 6 vjecar. Dokumenti eshte fiktiv.
- Mjeti greider, marre me qira nga “Spartaku” shpk ne daten 12.05.2017, ne daten 15 prill 2016 i eshte dhene me qera shoqerise “Glavenica” shpk me afat 5 vjecar. Dokumenti eshte fiktiv.
- Mjetet ekskavator fiat hitachi, ekskavator caterpillar dhe ekskavator cat 215, marre me qira nga “Spartaku” shpk ne daten 12.05.2017, ne daten 9 shkurt 2016 i jane dhene me qera shoqerise

“Glavenica” shpk me afat 5 vjecar. Dokumenti eshte fiktiv.

5. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “ED Konstruksion” shpk (87,1%) dhe “Spektri” shpk (12,9%) pasi:

Shoqeria “ED Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi gjate vitit 2017 dhe 2018, referuar puneve te ngjashme te deklaruar ne tender, ka ushtruar aktivitet ne bashkine Dropull (Unaza e Pogonit, loti 1) dhe nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e taksave dhe tarifave vendore.

Shoqeria “ED Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.9 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve pasi ka paraqitur mjetin autobitumatrice me targe AA230HV, marre me qera nga “A Klas Beton” shpk ne daten 23.10.2018, nderkohe qe i njeiti mjet i eshte dhene me qera shoqerise “Riviera” shpk ne daten 20.10.2018 me afat 3 vjecar. Dokumenti eshte fiktiv.

Shoqeria “Spektri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi gjate vitit 2017 dhe 2018, referuar puneve te ngjashme te deklaruar ne tender, ka ushtruar aktivitet ne bashkine Gjirrokaster (Ndertim i sistemit te ngrohjes ne shkollat 9 vjecare “Koto Hoxhi”, “AZ Cajupi” dhe “Urani Rumbo”) dhe nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e taksave dhe tarifave vendore. Gjithashtu, gjate vitit 2017, referuar puneve te ngjashme te deklaruar ne tender, ka ushtruar aktivitet ne bashkine Patos (Rikonstruksion i rruges unaze Grize Velaj) dhe nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e taksave dhe tarifave vendore.

6. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Lala” shpk (53,27%) dhe “Biba X” shpk (46,73%) pasi:

Shoqeria “Lala” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi gjate vitit 2017, referuar puneve te ngjashme te deklaruar ne tender, deri ne daten 05.06.2017 ka ushtruar aktivitet ne bashkine Sarande (Rehabilitimi i linjes se furnizimit me uje dhe kanalizime ne qytetin e Sarandes) dhe nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e taksave dhe tarifave vendore.

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur pune te ngjashme vetem per punime rrugore, por nuk ka paraqitur asnje pune te ngjashme per punime ndertimore per godina.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me shqyrtimin e dokumentacionit per kualifikim te paraqitur nga ky bashkim shoqerish.

7. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Fusha” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me paraqitjen e deklarates se disponueshmerise se mjeteve sipas shtojces 10, pasi ne deklaraten e paraqitur deklaroi disponueshmerine e mjeteve per objektin “Rikonstruksioni i rrugeve te brendeshme dhe rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit tek shkambi i kavajes, bashkia Durrës” dhe jo per objektin qe prokurohet.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 dhe 2.3.5 per kualifikim lidhur me disponimin e inxhinierëve, pasi

inxhinieri i propozuar gjeodet Artur Asllani eshte i deklaruar dhe i angazhuar ne proceduren “Rikonstrukcion bulevardi i Vlores”, ne te cilen kjo shoqeri eshte shpallur fituese ne daten 19.03.2018. Kontrata perkatese eshte lidhur me Fondin Shqiptar te Zhvillimit ne daten 21.03.2018, perpara dates se hapjes se ofertave, dhe punimet jane ne proces.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“Hastoci” shpk**, me adrese: rruga Pjeter Bogdani, pallati nr 17, apartamenti 5/3, perballe kopshtit nr 31, me NIPT J62028009B, se oferta e paraqitur, me vlerë **193.736.484 (njëqind e nëntëdhjete e tre milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katerqind e tetedhjetë e kater) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjor nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **29.10.2018**.

Per proceduren,ne daten 06.11.2018 paraqiti ankese shoqeria “Sterkaj” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 06.11.2018 duke mos e pranuar ate. Ankime ne KPP nuk ka patur.